مِنهجٌ مَوجُزٌ فِي طَلَبِ العِلمِ

Një Metodologji e Përmbledhur në Kërkimin e Dijes

HAQQ DAWAH

SHEJKH NASIR EL-FEHD

منهج موجز في طلب العلم

Një Metodologji e Përmbledhur në Kërkimin e Dijes

Shejkh Nasir El-Fehd

حق دعوة
HAQQ DAWAH

Shenimi i Botuesit

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirëbërësit, fil-loj. E gjithë lavdia i takon Allahut, të Plotfuqishmit dhe të Fortit; dhe *salavatet* e *selamet* e Allahut qofshin mbi atë që u dërgua me shpatë si mëshirë për krijesat. Sa për atë që vijon…

Jemi të nderuar të paraqesim dhe falënderojmë Allahun pafund për begatitë dhe mirësitë e Tij, një përkthim në shqip të një trajtese të shkurtër mbi metodologjinë e kërkimit të dijes së shenjtë, të shkruar nga dijetari i shtypur dhe i burgosur, Shejkh Ebu Mus‘ab Nasir ibn Hamad el-Fahd (*Allahu ia lehtësoftë gjendjen atij dhe të gjithë muwahhidin-ëve tanë të burgosur në Gadishullin Arabik dhe gjetkë*). Në realitet, ai nuk ka nevojë për prezantim. Ai njihet nga armiqtë dhe miqtë njësoj. Shkrimet e tij janë të përhapura dhe fjalët e tij dëgjohen. Ai është prej një race të rrallë *dijetarësh* që ishin të gatshëm të sakrifikonin jetën e tyre për të thënë të vërtetën. Kur të mësosh, o vëlla në fe *(akhi fil-lah)*, se kush janë dijetarët e vërtetë të këtij *umeti*, trashëgimtarët e profetëve, do të kuptosh në të njëjtën kohë edhe se kush janë tradhtarët e këtij *umeti* nga dijetarët e tij – trashëgimtarët e Bal‘am ibn Baura dhe rabinëve gënjeshtarë he-brenj.

Në këtë trajtesë, *shejhu* përshkruan shkurtimisht një rrugë për atë të cilit Allahu ia ka hapur gjoksin për kërkimin e dijes islame. Trans-metohet nga Mu‘avije *(radijallahu anhu)* se e dëgjoi Profetin *(alejhi selam)* duke thënë: “Atij që Allahu ia do të mirën, i jep kuptimin e *fesë.*” Prandaj, gëzohu nëse Allahu ta ka hapur zemrën për

të kërkuar dijen e *fesë*. Falëndero Allahun për këtë begati vazhdimisht dhe mos ji mosmirënjohës duke u larguar prej saj. Mosveprimi sipas dijes shfaqet në shumë mënyra; mund të jetë përmes arrogancës, ndërsa dija për përulësinë është me ty, ose mund të jetë në forma edhe më të rënda që çojnë në *kufër*, siç shihet me dijetarët e *tagutëve*, Allahu na ruajtë!

Ai (*'Azze ue Xhel*) ka thënë: "Dhe tregoju atyre tregimin e atij të cilit Ne i dhamë ajetet Tona, por ai i hodhi poshtë, kështu që S*hej-tani* e ndoqi atë dhe ai u bë prej atyre që humbën rrugën. Dhe sikur të kishim dashur, do ta kishim ngritur atë me ato (*ajetet*), por ai u mbështet në tokë dhe ndoqi dëshirat e tij të kota. Shembulli i tij është si shembulli i një qeni: nëse e përzë, ai nxjerr gjuhën; nëse e lë të qetë, ai përsëri nxjerr gjuhën. I tillë është shembulli i atyre që mohojnë *ajetet* Tona. Prandaj, tregoju tregimet, që ndoshta ata do të mendojnë."[1] Reflekto dhe medito, o vëlla fisnik *(akhi el-kerim)*, pastaj reflekto dhe shqyrto përsëri *ajetet* e Allahut. Allahu të ruajtë!

Meqë kjo trajtesë është shkruar fillimisht në arabisht, ajo është e përshtatur më shumë për ata që tashmë lexojnë dhe kuptojnë këtë gjuhë. Prandaj, lexuesi shqipfolës do të vërë re se shumë nga veprat që autori përmend dhe rekomandon nuk janë të përkthyera në shqip. Kjo duhet të na motivojë të përpiqemi për të kuptuar gjuhën arabe, sepse aty gjendet dija dhe aty do të shohim nga afër se çfarë kanë fshehur dhe shtrembëruar dijetarët e *tagutëve*, jo vetëm në Lindje, por edhe në Perëndim.

[1] El-A'raf: 175-176

Shënimet tona janë shënuar me termin "*Shënimi i botuesit*", ndërsa të tjerat i përkasin autorit. Jo të gjitha shënimet nga origjinali në arabisht janë përfshirë. Lusim Allahun që ta pranojë këtë punë nga ne dhe të na udhëzojë në rrugën e drejtë në dije dhe vepra.

Së fundmi, përfundojmë duke thënë se e gjithë lavdia i takon Allahut, Zotit të botëve.

***Sheval* 1446**

E GJITHË LAVDIA I TAKON Allahut. Dhe *salavatet* dhe *selamet* [e Allahut] qofshin mbi të Dërguarin e Allahut (*sal-lAllahu alejhi ue selem*) Sa i përket asaj që vijon…

Disa vëllezër të virtytshëm menduan mirë për mua duke supozuar se tumori ishte mish[2] prandaj më kërkuan që t'u përshkruaj një metodologji për kërkimin e dijes. Unë tashmë kisha përpiluar një draft të një libri mbi këtë temë, por nuk mund ta përfundoj për momentin për shkak të rrethanave që nuk janë të fshehta. Prandaj, pashë të arsyeshme që të shkruaj një përmbledhje të asaj që përmbante ai, sipas asaj që mund të përshtatet në këtë letër. I lutem Allahut që ta bëjë të dobishme.

Së pari: *el-Ikhlas* (Sinqeriteti)

Është e domosdoshme që studenti i dijes të pastrojë qëllimet e tij; dhe kjo urdhëresë është e njohur. Megjithatë, rruga është e gjatë, grabitësit e saj janë të shpërndarë, dhe sprovat që ndikojnë në qëllimin janë të shumta dhe të fshehura. Prandaj, është e nevojshme që studenti i dijes ta përtërijë qëllimin e tij vazhdimisht, pasi ai ndryshon shumë herë.

[2] Shënimi i botuesit: Kur një qengj kishte një tumor në trupin e tij, disa mund të supozonin se ai po shëndoshej dhe për rrjedhojë do të kishte më shumë mish. Prandaj, arabët përdornin këtë shprehje. Kjo mund të nënkuptojë "mbivlerësim" ose diçka të ngjashme në anglisht.

Së dyti: *Tazkija en-Nefs* (Pastrimi i Shpirtit)

Kjo arrihet përmes veprave të bindjes, përkushtimit ndaj istigfarit (kërkimit të faljes), përtëritjes së teubes (pendimit) dhe shmangies së mosbindjes, pasi ato janë ndër pengesat më të mëdha në ndjekjen e dijes. Studenti i dijes privohet nga [dija], harron atë që ka mësuar dhe i vështirësohet kuptimi, e gjitha kjo si pasojë e mosbindjes.

E treta: Kërkimi i ndihmës nga Allahu (*te'ala*)

Të kërkosh prej Tij, t'i lutesh Atij, të përulesh para Tij, të dorëzohesh me zemër të thyer para Tij, të kërkosh prej Tij udhëzim dhe drejtësi, të mbështetesh në fjalën: "*La haule ve la kuvvete illa bil-lah*" – (Nuk ka forcë e as fuqi, përveçse me Allahun),
si dhe shumë prej duave që janë transmetuar në këtë temë, si:

رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

"*Rabbi zidni ilma*" (Zoti im, më shto dije)

سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا، إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيم

"*Subhaneke la ilme lena illa ma allemtene, inneke Ente'l-Alim el-Hakim*" (Qofsh i lavdëruar! Ne nuk kemi dije përveç asaj që na ke mësuar Ti. Vërtet, Ti je i Gjithëdituri, i Urti)

اللَّهُمَّ عَلِّمْنِي مَا يَنْفَعُنِي، وَانْفَعْنِي بِمَا عَلَّمْتَنِي

"Allahumme allimni ma jenfeuni, venfe'ni bima allemteni"
(O Allah, më mëso atë që më sjell dobi dhe më bëj dobi nga ajo që më ke mësuar)

اللَّهُمَّ فَقِّهْنِي فِي الدِّينِ وَعَلِّمْنِي التَّأْوِيلَ

"*Allahumme feqqihni fid-din, ve allimni't-te'vil*" (O Allah, më jep kuptim të thellë në fe dhe më mëso interpretimin e saj)

اللَّهُمَّ يَا مُعَلِّمَ آدَمَ وَإِبْرَاهِيمَ عَلِّمْنِي، وَيَا مُفَهِّمَ سُلَيْمَانَ فَهِّمْنِي

"*Allahumme ja Muallime Ademe ve Ibrahime allimni, ve ja Mufehhime Sulejmana fehhimni*" (O Allah, o Ai që ia mësove dijen Ademit dhe Ibrahimit, më mëso edhe mua. O Ti që ia dhe kuptimin Sulejmanit, më jep edhe mua kuptim)

E katërta: *al-'Amal* (Veprimi me dije)

Është detyrë për nxënësin e dijes që të veprojë sipas dijes së tij, sepse ky është qëllimi i dijes jo për ta zbukuruar veten me të para njerëzve. Prandaj, i takon atij të përpiqet në bindje ndaj Allahut dhe të shtojë veprat *nafile* (vullnetare), si: *kijami* (namazi i natës), *sijami* (agjërimi), *sadakaja* (lëmosha), leximi i Kuranit, *dhikri* (përmendja e Allahut), dhe të tjera si këto. Dua të ndalem në dy çështje të rëndësishme këtu:

1. Të merresh vetëm me lexim librash, memorizim të *mëtuneve* (tekste të shkurtra), mbledhje dhe mësim të dijes, mund të sjellë ashpërsi në zemër, duke e bërë adhurimin të rëndë për nxënësin. Për këtë arsye, gjatë periudhave të studimit, ai duhet të marrë kohë edhe për adhurim vullnetar. Duhet të lexojë jetën e të drejtëve dhe të devotshmëve, sepse kjo zbut zemrën dhe motivon për vepra, me lejen e Allahut.

2. Këtu ekziston një keqkuptim që disa nxënës dembelë e përhapin ata që e kanë të lehtë të mësojnë, por u bëhet e rëndë adhurimi. Ata thonë: "Kërkimi i dijes është më i mirë se veprat vullnetare të adhurimit." Ky keqkuptim nuk duhet ta mashtrojë askënd, sepse këto dy çështje nuk bien ndesh me njëra-tjetrën

> në mënyrë që të detyrohesh të zgjedhësh njërën mbi tjetrën. Mjafton të hedhësh një sy mbi dijetarët e mëdhenj të këtij *umeti*, nga *Sahabët*, *Tabi'inët* dhe pasuesit e tyre, për të parë se ata ishin të njohur për adhurimin e tyre të fortë. Dija ka përparësi mbi adhurimin vetëm kur ka përplasje midis të dyjave dhe nuk ka mënyrë për t'i bashkuar, e kjo ndodh vetëm në raste shumë të rralla dhe të veçanta.

E pesta: Dija nuk arrihet me rehati të trupit

Nxënësi i dijes duhet të punojë fort, të jetë i përkushtuar dhe të bëjë përpjekje të mëdha, sidomos në fillimet e kërkimit të dijes. Është thënë:"**Suksesi përbëhet nga një e dhjeta zgjuarsi dhe nëntë të dhjetat përpjekje e lodhshme.**" Kushdo që ankohet për dobësi në memorizim apo kuptim, mund ta kompensojë këtë përmes një vullneti të fortë, largimit nga dembelia dhe shtimit të përpjekjeve. Kush ka synime të larta, e pastron nijetin dhe përpiqet me serioz në çështjet e tij, do të arrijë qëllimin me vullnetin e Allahut.

E gjashta: Dija është shumë e gjerë për t'u përfshirë e gjitha, prandaj merr prej çdo dijeje atë që është më e dobishmja

Nxënësi i dijes nuk duhet të merret veçanërisht në fillimet e tij me çështjet e ndërlikuara, të rralla dhe të çuditshme të dijes, të cilat nuk kanë ndonjë vlerë të vërtetë përveçse për të humbur kohën apo për të bërë konkurrencë me të tjerët. Përkundrazi, ai duhet të fokusohet që të zotërojë bazat dhe parimet themelore të dijes, të përvetësojë rregullat kryesore dhe të kuptojë çështjet më të rëndësishme e më të nevojshme.

E shtata: Prej begative të dijes është drejtësia dhe largimi nga fanatizmi

Prandaj, nxënësi i dijes duhet të kërkojë të vërtetën, duke u mbështetur në argumentet e saj nga Libri i Allahut (Kurani) dhe Suneti i Pejgamberit (*sal-lAllahu alejhi ue selem*), pa u fanatizuar (pa u lidhur verbërisht) për një *medhheb* të caktuar, një dijetar apo një *shejh* të caktuar. Sepse çdo njeri, fjala e tij mund të pranohet apo të refuzohet përveç fjalës së të Dërguarit të Allahut (*sal-lAllahu alejhi ue selem*), fjalët dhe veprat e të cilit janë argument i padiskutueshëm.

E teta: Kush neglizhon parimet, i pamundësohet arritja e qëllimit

Parimet (*usulet*) janë të dy llojeve:

1. Parimi themelor i të gjitha shkencave islame, dhe ai është **Teuhidi** — Njësimi i Allahut. Nxënësi i dijes nuk ka asnjë justifikim të jetë injorant në lidhje me këtë bazë, sepse është themeli i fesë dhe i gjithë dijes fetare.

2. *Usulet* ose bazat e çdo shkence specifike që nxënësi studion këtu me usul nënkuptohet kuptimi i përgjithshëm i fjalës, jo kuptimi i saj teknik. Pra, *bazat* e çdo fushe janë: kapitujt më të rëndësishëm, temat më të vlefshme, termat themelorë dhe çështjet kryesore që ndërtojnë atë shkencë.

E nënta: Nuk konsiderohet dije përveç asaj që ruhet në zemër (*memorizohet*)

Prandaj, është e domosdoshme për nxënësin e dijes që të angazhohet me memorizimin si të teksteve themelore (*mutun*), ashtu edhe të argumenteve (*ajeteve dhe haditheve*), thënieve të dijetarëve dhe çështjeve thelbësore të çdo fushe. Memorizimi ka katër nivele:

1. Të memorizosh fjalët origjinale të *mutunit* dhe ky është themeli i ndërtimit të dijes. Nxënësi nuk duhet të largohet nga ky metodë, përveç nëse e ka tepër të vështirë.

2. Të memorizosh *mutunin* me kuptim që do të thotë se nxënësi e zotëron të gjithë tekstin, ose fjalë për fjalë, ose përmes përmbledhjes së kuptimit të tij, pa u kufizuar patjetër në fjalët e autorit, pasi kjo nuk është çështje adhurimi.

3. Të zgjedhësh atë që do të memorizosh nëse teksti është shumë i gjatë dhe nxënësi e ka të vështirë memorizimin e plotë, atëherë ai e shkurton tekstin derisa të bëhet i lehtë për të. Këtë e bën duke zgjedhur pjesët më të rëndësishme e thelbësore të tekstit, në rast se është tekst i shkruar, ose vargjet më të rëndësishme, nëse është poezi. Në këtë zgjedhje ai duhet të kërkojë ndihmën dhe udhëzimin e dijetarëve të përvojës. Pastaj e memorizon atë që ka përzgjedhur.

4. Të zgjedhësh se çfarë do të ruash qoftë fjalë për fjalë, qoftë me kuptim.

E dhjeta: Dija është si gjueti, ndërsa shkrimi është si kapja e saj

Nxënësi i dijes nuk duhet të mbështetet gjithmonë te kujtesa e tij, sepse memoria të tradhton dhe ajo që është mësuar përmendësh mund të humbasë, ndërsa ajo që shkruhet ruhet. Prandaj, ai duhet të kujdeset të mbledhë dhe të përmbledhë përfitimet dhe të grumbullojë njohuritë e tij.

E njëmbëdhjeta: Kush kërkon dijen me grumbull (*njëherësh*), ajo do ta braktisë atë me grumbull (*njëherësh*)

Prandaj, është detyrë e nxënësit të dijes që t'i marrë çështjet me radhë dhe ta mësojë dijen hap pas hapi, pak nga pak, dhe të mos kalojë nga një çështje në tjetrën pa e përvetësuar mirë atë të parën. Sepse grumbullimi i tepërt i dijes në mendje, shpesh çon në humbjen dhe zhdukjen e saj.

Etapat e njohura të kërkimit të dijes janë tre:

1. Për fillestarët: është të marrë një kuptim të përgjithshëm të çështjeve; kjo njihet si "etapa e *mutuneve* (teksteve themelore)". Në këtë fazë, nxënësi njihet me terminologjitë e shkencave, çështjet dhe strukturën e tyre, dhe është e domosdoshme për të që të përqendrohet në kuptimin e fjalëve dhe termave, pa e lodhur mendjen me saktësimin dhe thellimin në çështje të ndërlikuara.

2. Për fazën e mesme: është për thellim dhe kuptim të plotë; kjo njihet si "etapa e komenteve të *mutuneve* (teksteve themelore)". Në këtë fazë, nxënësi hulumton rreth çështjeve të ndryshme, provave të tyre dhe dallon atë që është më e saktë prej tyre.

3. Për të qëndrueshmit dhe të përforcuarit në dije: është për zgjerim dhe *ixhtihad*; kjo njihet si "etapa e veprave të mëdha dhe të detajuara". Në këtë fazë, nxënësi zgjerohet në degët e ndryshme të dijes, hulumton çështje më të hollësishme dhe merret me mospajtimet mes dijetarëve, etj.

Sa i përket librave të caktuar për çdo etapë, ato ndryshojnë në varësi të kohës, vendit, *medh'hebit* dhe *mësuesit*. Dhe ajo që do të përmendet këtu nuk është domosdoshmërisht e detyrueshme për të gjithë.

TEUHIDI

1. ***Teuhidul-Ibadah***: Studenti duhet të fillojë me veprat më të shkurtra të Shejkh Muhamed ibn Abdul-Uehabit, si:

El-Usul eth-Thelâtheh, El-Kaua'id el-Arbe'a, dhe *[Kitab] et-Teuhid,* pastaj të kalojë te shpjegimet dhe komentet e tyre. Pas kësaj, te veprat më të gjata nga librat e Ibn Tejmijes dhe dijetarëve udhëheqës të *da'ues*, si: *Ed-Durar es-Senijjeh* dhe të tjerë.

2. ***Teuhidul-Esma ues-Sifat:*** Duhet të fillosh me veprat më të shkurtra të Shejkhul-Islam Ibn Tejmijes, si: *El-Uasitijjeh* dhe *El-Hamawijjeh,* pastaj *Et-Tedmurijjeh* dhe shpjegimet e *El-Uasitijjes*. Pastaj vazhdohet me veprat më të gjata në këtë temë, si: Kategoritë e akides nga *Mexhmu' el-Fetaua, Dar'u Te'arud el-'Akl ue en-Nakl, Es-Seua'iq el-Mursaleh,* dhe të t-jera..

KUR'ANI

1. ***Tefsiri:*** Është një dituri e avancuar, dhe librat që i përkasin asaj janë të gjera e të thelluara, madje edhe versionet e tyre të përmbledhura janë të gjata. Këtu nuk ka *mutune* (tekste të shkurtra për memorizim). Prandaj, është më e përshtatshme që studenti i dijes të përvetësojë pjesë nga dituritë e tjera për-para se të hyjë në këtë fushë. Ka shumë libra të *tefsirit*, dhe shumica prej tyre nuk janë të pastra nga *bidatet*. Librat më të rëndësishëm të *tefsirit* janë ata të: Taberiut, Bagaviut, Ibn Kethirit, Ibn Sa'diut, dhe *Ed-Durr el-Menshur* nga Sujuti.

2. ***Usul et-Tefsir***: Ndër *mutunet* më të shkëlqyera këtu është *Mukaddimet et-Tefsir* nga Shejkhul-Islam Ibn Tejmije. Janë shkruar shumë komente dhe shënime mbi të që janë botuar. Unë e kam përmbledhur atë dhe kam shtuar çështje të tjera nga fjalët e Ibn Tejmijes, dhe kjo mund të gjendet në inter-net.

3. ***'Ulum el-Kuran***: Ndër veprat më të përshtatshme që janë shkruar në këtë fushë është *El-Itkan* nga Sujuti, ndonëse në të gjenden disa *bidate*.

HADITH

Mutunet e tij janë të shumta; më të njohurat janë: '*Umdetul-Ahkam* nga el-Makdisi, *Bulughul-Meram* nga Ibn Haxher, *el-Muharer* nga Ibn 'Abdil-Hadi, dhe *el-Munteka* nga el-Mexhd Ibn Tejmijje. Për studentin, i takon të fillojë me '*Umdetul-Ahkam*, për shkak të shkurtësisë së saj, pastaj të vazhdojë me *Bulughul-Meram* ose *el-Muharer*, pasi ato janë afërsisht të barabarta. Më pas, duhet të kalojë te komentet e këtyre librave, e pastaj te veprat më të gjata, si: *Fet'hul-Bari, Sharh Muslim, Neylul-Evtar,* dhe të tjera.

MUSTALAHUL EL-HADITH

Ndër *mutunet* më të njohura në këtë fushë janë: *El-Bejkunijjeh, Nukhbetul-Fikr* nga Ibn Haxher, *el-Mukidha* nga edh-Dhehebi, pastaj komentet e tyre, së bashku me sqarimet për *Mukaddimet Ibn es-Salah*. Pas kësaj vjen studimi i librave të burimeve të *haditheve*, të mangësive të fshehta (illet), librat e historive të transmetuesve (rijal), etj.

Ka dy çështje që dëshiroj t'i theksoj:

Së pari, humica e librave të diturisë së *hadithit* që ekzistojnë sot janë ndërtuar mbi metodologjinë e dijetarëve të vonshëm të *hadithit,* në kundërshtim me *menhexhin* e dijetarëve të hershëm.

Së dyti, vetëm studimi teorik dhe i thatë i kësaj shkence ka pakdobi. Prandaj është e domosdoshme që studenti i

dijes, nëse dëshiron dobi të vërtetë, të ushtrohet në aplikim praktik, të hulumtojë vetë burimet e *hadithit*, të shikojë zinxhirët e transmetimit dhe mangësitë e fshehta.

USUL EL-FIKH

Këtu, tekstet e njohura (mutun) janë *Al-Uaraqat* nga al-Xhuvejni, *Mukhtasari* i Ibn al-Haxhibit, dhe *Al-Minhaxh* nga al-Bejdawi, pastaj komentet mbi to, e më pas veprat më të gjata si *Al-Mustasfa, Al-Ihkam, Al-Bahr al-Muhit,* e të tjera.

Ka dy çështje që dëshiroj t'i përmend këtu:

Së pari, shumica e librave të usulit nuk janë të pastra nga *bidatet* e *mutekeliminëve* (njerëzve të kelamit). Përjashtimet, megjithatë, përfshijnë *Rawdat en-Nadhir* nga Ibn Kudameh, dhe shënimet mbi të nga esh-Shanqiti që janë publikuar me titullin *Mudhkirah fi Usul al-Fikh*. Po ashtu ke edhe *Sherh el-Kaukeb el-Munir* nga Ibn en-Nexhhar el-Futuhij. Dhe unë kam përmbledhur *Usul el-Fikh të Shejhul-Islam Ibn Tejmijes*, i cili mund të gjendet në internet.

Së dyti, librat e *usulit* janë të vështirë për t'u kuptuar për shkak të shumës së madhe të termave teknikë dhe shprehjeve të ndërlikuara. Prandaj, është më e përshtatshme që fillestari të fillojë me leximin e veprave të dijetarëve bashkëkohorë në këtë shkencë, sepse ato janë më të lehta për t'u kuptuar dhe përdorin një gjuhë më të thjeshtë. Këto përfshijnë: *Usul el-Fikh* nga Hallaf, el-Khudari, Zejdan, dhe të tjerë. Pasi të përfundojë me to, atëherë kalon te veprat e dijetarëve të hershëm.

FIKH

Mutun-et ndryshojnë sipas medhhebeve të ndryshme: *Al-Kenz* për hanefitë, *Mukhtasar el-Khalil* për malikijtë, *El-Minhaxh* për shafi'itë, dhe *Zad el-Mustaqni'* për hanbelitë. Pastaj kalon te komentet mbi to, e më pas te veprat më të gjata si *El-Mughni*, *El-Mexhmu'*, e të tjera. Ndërsa për atë që nuk ndjek një medhheb të caktuar, për të është *Ed-Durrar el-Behijjeh* nga esh-Shaukani dhe komentimi i saj *Er-Rawdah en-Nadijjeh* nga Siddik el-Kanuxhi.

Ka dy çështje që dëshiroj t'i përmend këtu:

Së pari, shumë prej atyre që në ditët tona i atribuohen ndjekjes së *hadithit*, kritikojnë ndjekjen e një medhhebi dhe këtyre librave, por kjo ka nevojë për shqyrtim; ajo që është e qortueshme është fanatizmi i verbër. Nuk ka asnjë problem në mësimin dhe njohjen e medhhebeve përmes këtyre librave. Dhe këtu ka një sqarim të detajuar, të cilin nuk është vendi ta shtjellojmë tani.

Së dyti, unë i rekomandoj studentit [të dijes], pasi të ketë njohur *fikhun* dhe *usulin* e tij, të lexojë librat e *el-fukaha el-ahrar* (dmth. dijetarët e lirë të fikhut), ata që nuk janë të lidhur ngushtë me një medhheb të caktuar: Ibn Hazmi, Ibn Tejmijje, Ibn el-Kajjim dhe esh-Shaukani.[3] Këta ndihmojnë shumë studentin dhe e ndihmojnë atë të zhvillojë aftësinë për *ixhtihad*, t'u japë rëndësi të lartë teksteve të shpallura, dhe t'i vlerësojë fjalët e njerëzve vetëm nëse përputhen me ato.

[3] Duke qenë të vetëdijshëm se Ibn Hazmi është nga *Zahirijjet* dhe esh-Shaukani nga *Zahirijjet* prej njerëzve të *hadithit*; ata që pranojnë atë që gjendet në tekste dhe kuptimet e tyre, por hedhin poshtë *kijasin e 'iletit* (deduksionin përmes shkakut). Për shkak të kësaj, prej tyre kanë dalë shumë mendime të çuditshme që kundërshtojnë *ixhmanë*. Prandaj, është e përshtatshme që studenti të fillojë me leximin e *I'lam el-Muvekki'in* nga Ibn el-Kajjim para se të kalojë te veprat e tyre, pasi ai është prej më të mirëve që është shkruar për *usul* dhe trajtimin e teksteve, duke shmangur njëkohësisht ngurtësinë e ndjekësve të *kijasit* dhe teprimin e *Zahirijjëve*.

AN-NAHW (Gramatika)

Studenti [i dijes] fillon me *El-Axhurrumijjeh*, duke vazhduar me komentimin e saj *Et-Tuhfah es-Senijjeh*, së bashku me librat e përmbledhur të Ibn Hishamit, si *Sherh Shudhur edh-Dheheb* dhe *Sherh Kattr en-Neda*, e pastaj kalon te veprat më të detajuara si *Mughni el-Lebib* dhe komentet mbi *El-Alfijjeh,* e të ngjashme.

Ka dy çështje që dëshiroj t'i përmend këtu:

Së pari, zotërimi i an-nahw në teori nuk do të thotë se njeriu është i sigurt nga gabimet gramatikore për shkak të ndikimit të edukimit të mangët, sepse dihet se edhe disa prej dijetarëve më të mëdhenj të an-nahw-ut kanë rënë në gabime gramatikore. Një prej mënyrave më të mira për të përmirësuar gjuhën (dmth. shqiptimin dhe të folurit) është që studenti [i dijes] të lexojë një numër librash me *tashkil* (dmth. me harakat), duke i shqiptuar me zë të lartë. Sa më shumë të lexojë në këtë mënyrë, aq më rrjedhshëm do të bëhet gjuha e tij, dhe me përsëritje, studenti [i dijes] fiton aftësi natyrale dhe njohuri të gjuhës arabe nëse Allahu (*te'ala*) e do këtë për të.

Së dyti, përkryerja e an-nahw-it teorikisht dhe praktikisht do të thotë të jesh i mbrojtur nga gabimet gramatikore dhe të njohësh *i'rab-in* (ndryshimin e fjalëve sipas funksionit në fjali); nuk do të thotë të kesh elokuencë në të folur, një paraqitje të bukur ose një stil mbresëlënës. Kjo gjendet në librat e *edebit*, jo në an-nahw. Prandaj, nëse studenti [i dijes] dëshiron të përmirësojë stilin e tij, ai duhet të shfletojë librat e poezisë arabe, veprat mbi elokuencën dhe autorët e të folurit të bukur. Ai duhet të përpiqet të mësojë përmendësh sa më shumë poezi dhe thënie nga *edebi*, dhe

të referohet te librat e *el-insha-s*[4] si *El-Methal es-Sa'ir* i Ibnul-Ethirit, e të ngjashme.

Dymbëdhjeta: Bashkimi midis dy llojeve të *Fikhut*

Pasi nxënësi i dijes të arrijë kuptimin e *sheriatit*, duhet të fitojë edhe kuptimin e *waqi'* (realitetit në terren), në mënyrë që ta lidhë atë me *sheriatin* dhe të njohë gjykimin përkatës. Ai vëzhgon shkollat bashkëkohore të mendimit sa i përket besimeve dhe teorive, mëson çështjet e reja të *fikhut*, i referohet librave që përmbajnë enciklopeditë e reja dhe ndjek zhvillimet aktuale; por duhet të ruajë ekuilibrin, që kjo të mos bëhet barrë për të.

Trembëdhjeta: Ai që fillon herët të mësojë të tjerët, humb shumë dije

Nxënësi i dijes duhet të përpiqet të forcohet në dije para se të nisë t'u mësojë të tjerëve. Gjithashtu, duhet të vazhdojë të mësojë edhe pasi të fillojë mësimdhënien, ashtu siç ka thënë Imam Ahmedi: "(Kërkimi i dijes është) nga djepi deri në varr."

Katërmbëdhjeta: *Edebi* i kërkimit të dijes

I takon nxënësit të dijes të zbukurohet me moral dhe edeb në kërkimin e dijes, qoftë me veten e tij, me mësuesit, kolegët, nxënësit apo të tjerët. Shumë dijetarë të hershëm dhe të vonshëm kanë shkruar vepra të shumta për këtë temë, prandaj është më mirë t'u referohet atyre

[4] Shënimi i botuesit: Është shkenca përmes së cilës mësojmë si të zhvillojmë dhe të radhisim ndjenjat, emocionet, mendimet dhe përshkrimet në shprehje të qarta në gjuhën arabe. Njihet gjithashtu si arti i kompozimit.

Dhe në fund

Këto janë disa shkrime dhe trajtesa që i këshilloj kërkuesit të dijes t'i lexojë, t'i studiojë vazhdimisht dhe t'u rikthehet shpesh:

1. Të gjitha shkrimet e Shejhul-Islam Ibn Tejmijes dhe nxënësit të tij Ibn Kajjim (*rahimehumullah*), sepse veprat e tyre janë të mbështetura mbi kuptimin e Librit dhe Sunetit, dhe janë themeli i metodologjisë *selefije*.[5]

2. Të gjitha shkrimet e Hafidh edh-Dhehabiut (*rahimehullah*), sepse ai ishte, vërtetë, një hulumtues i thellë dhe i përpiktë.

3. Të gjitha shkrimet e Hafidh Ibn Rexhebit (*rahimehullah*), veçanërisht: *Fethul-Bari, Sherhu 'Ilal-it, Xhami'ul-Ulum*, dhe *El-Kaua'id*, për shkak të dobi ve të shumta që gjenden në to e që nuk gjenden në libra të tjerë.

4. *Fethul-Bari* i Hafidh Ibn Haxherit, sepse nuk është vetëm një shpjegim i Sahih Bukhariut, por është një sqarim për të gjitha librat e *sihahëve* (shumësi i sahih), *suneneve* dhe *musnedeve* (shumësi i musned); dhe është referenca kryesore për komentuesit e *hadithit* pas tij.

[5] Nuk e dua askënd më shumë, pas njerëzve të brezave të bekuar, sesa pesë prej dijetarëve kryesorë. Dhe unë, pasha Allahun, bëj lutje për ta gjatë sexhdes sime. Ata janë: Shejhul-Islam Ibn Tejmije, nxënësi i tij Ibn Kajjim, Imami Muhamed ibn Abdul-Uehhab, nxënësi i tij Abdul-Aziz ibn Muhamed ibn Su'ud, dhe shejhu ynë Hamud esh-Shuejbi. Allahu i mëshiroftë të gjithë!

5. Të gjitha shkrimet e dijetarëve kryesorë të *davetit Nexhdij (rahimehumullah)*, veçanërisht *Ed-Durar es-Senijjeh*, sepse është, siç e tregon edhe emri i saj.[6]

6. Të gjitha shkrimet e shejhut Abdurrahman el-Muallimi *(rahimehullah*), i cili është si edh-Dhehabi i kohës sonë, veçanërisht: *Et-Tenkil* dhe *El-Envar el-Kashifeh.*

7. Shënimet e shkruara nga shejhu Abdurrahman ibn Kasim mbi *Er-Raud el-Murbi'*, sepse është prej më të mirëve që është shkruar në *fikh*, dhe në të gjenden pika, xhevahire dhe dobi që nuk gjenden diku tjetër.

8. Të gjitha shkrimet e shejhut Bekr Ebu Zejd (*rahimehullah*), sepse ai është ndër autorët më të mirë bashkëkohorë, me një paraqitje të qartë të çështjeve të ndryshme dhe me dobi të shumta.

9. Sa i përket asaj që kanë shkruar bashkëkohësit në shkencën e *hadithit*, veprat e shejhut Tarik ibn Auvdillah janë ndër më të mirat që janë shkruar; librat e tij janë të çmuar, dhe sqarimi i tij mbi *Nukhbetul-Fiker* është ndër shpjegimet më të mira.

Ky është udhëzimi që duhet ndjekur për ta lehtësuar arritjen e qëllimit.

Salavatet e Allahut qofshin mbi Profetin tonë Muhamedin, mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij të gjithë.

Nasir ibn Hamad el-Fehd

[6] Shënim i botuesit: Ed-Durar es-Senijjeh mund të përkthehet si "Perlat e shkëlqyera".